



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

## PAGESA DHE SHPËRBLIMET E KËSHILLTARËVE TË KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

### Shpërblimi dhe Rimbursimi i Këshilltarëve

1. Këshilltarët shpërblehen çdo muaj për punën që kryejnë sianëtarë të Këshillit. Masa e shpërblimit për çdo Këshilltar është *10% e rrogës së Kryetarit të Bashkisë*. Këshilli vlerëson mundësinë e shpërblimit shtesë për Kryetarin e Këshillit.
2. Anëtarët e Këshillit marrin shpërblimin, për kohën e:
  - a) pjesëmarrjes në Mbledhjet e Këshillit.
  - b) pjesëmarrjes në mbledhjet e komisioneve të Këshillit, në të cilat Këshilltari është zgjedhur anëtar.
  - c) pjesëmarrjes në grupet e punës ad-hoc të ngritura për probleme të veçanta, në të cilat këshilltari është i zgjedhur anëtar.
  - d) përfaqësimit të bashkisë jashtë kufijve administrative të saj, kur ai është deleguar nga Këshilli.
  - e) komunikimin dhe ndërveprimin me elektoratin dhe komunitetin.
  - f) konsultimin me bazen ligjore dhe ekspertizen.
3. Pjesëmarrja e Këshilltarëve në Mbledhjet e Këshillit dhe në mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm dokumentohet nga Sekretari i Këshillit, mbi bazë të procesverbaleve të Mbledhjeve. Sekretari mban regjistrin e përditësuar të pjesëmarrjes së Këshilltarëve në Mbledhjet e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershëm të Këshillit, si dhe harton raportin përkatës tre mujor dhe e paraqet në Mbledhjen e Këshillit.
4. Parimet e veçanta të shpërblimit për Këshilltarët, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.
5. Këshilltarë rimbursohen për shpenzimet e autorizuara dhe të bëra sipas vendimit të Këshillit dhe legjislacionit në fuqi.